

Regjistrimi klasa 5 - Viti shkollor 2024/25

Zgjedhje e lirë e shkollës

Pas klasës së katërt fëmija juaj frekuenton klasën e pestë të një shkolle të mesme.

Në Wolfsburg shumica e shkollave të mesme janë publike, pra **menaxhohen nga qyteti**. Përveç kësaj ka edhe **shkolla të pavarura**.

Për shkollat e mesme zbatohet një **qark shkolle gjithë qytetas**. Kjo do të thotë, nëse ju e keni vendbanimin tuaj në Wolfsburg jeni të lirë të zgjidhni një shkollë për fëmijën tuaj.

Megjithatë, mund të ndodhë që në disa shkolla të ketë më shumë regjistrime sesa vende shkolle në dispozicion.

Në këto shkolle duhet të bëhet **hedhje shorti**. Nga hedhja e shortit mund të rezultojë që fëmijë juaj të mos sigurojë një vend në shkollën e parë të zgjedhur. Prandaj, është e rekomandueshme që të mendoni paraprakisht për një **shkollë alternative**.

Ditët e regjistrimit në 2024

Ditët e regjistrimit për shkollat e mesme në menaxhim të qytetit (shkolla e përgjithshme e integruar, shkolla kryesore, shkolla e mesme "Realschule", shkolla e mesme "Oberschule", gjimnazi) janë nga data

22.04. – 25.04.2024 (ora 12:00)

Dita e mëvonshme e regjistrimit

(në rastin anulimit për shkak të hedhjes së shortit) është nga data **06.05. – 07.05.24 (ora 12:00)**.

Datat e regjistrimit të shkollave të pavarura i gjeni në:

<https://www.wolfsburg.de/schule>

Gjetësi i shkollës

Një përmbledhje të të gjitha shkollave të Wolfsburgut mund ta gjeni nëpërmjet kodit QR ose në: www.wolfsburgerlupe.de



Gjithë ditën

Ashtu si shkollat fillore të Wolfsburgut, edhe shkollat e mesme të Wolfsburgut janë shkolla që zgjasin gjithë ditën dhe ofrojnë falas një ofertë arsimore dhe kujdesi.

Regjistrimi

Gjatë regjistrimit në shkollën e mesme duhet të paraqitet **dëftesa origjinale e gjashtëmujorit të klasës së 4-t**. Deri në vërtetimin me shkrim të pranimit dëftesën e mban shkolla.

Me rëndësi: Ju lutemi, gjatë regjistrimit merrni me vete edhe certifikatën e lindjes.

Regjistrimi i njëkohshëm në disa shkolla nuk është i mundur.

Informacione të mëtejshme dhe persona të kontaktit

Këshillimi për shkollën

Marcel Brandes

05361/28-2325

Email: schulberatung@stadt.wolfsburg.de

Informacione të mëtejshme mbi temën e regjistrimit në shkollë dhe shkollës gjeni në:

<https://www.wolfsburg.de/schule>